

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.02.2024*

**16.02.2024
Ora 12:17**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.**

Parti Politike: PD (Z. Indrit Sefa, përfaqësues i PD)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita, në seancën e sotme kemi tre çështje në rendin e ditës.

- Projektvendimin “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2024”;

- pika e dytë, ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë;

- pika e tretë, ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kristian Luigj Shkreli, kryetar i Bashkisë Vau-Dejës Shkodër, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, me projektvendimin që ka të bëjë me shpërndarjen e fondeve vjetore, partive politike në formën e ndihmës financiare për vitin 2024.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.02.2024*

Znj. J. Josifi: Faleminderit! Përpara jush është paraqitur projektvendimi “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2024”. Në zbatim të nenit 19, pikat 1, shkronjat “k” dhe “n”, e 2 të ligjit Kodi Zgjedhor të ndryshuar, është parashikuar kompetenca e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të administruar buxhetin e KQZ-së sipas rregullave të fushës, si dhe për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it. Në zbatim të nenit 15/2, pika 2, shkronja “e”, e ligjit “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, përcaktohet masa e fondit publik që përfiton çdo parti politike në formën e ndihmës financiare vjetore. Në zbatim të nenit 19, pika 2, të po këtij ligji, parashikohen rregullat e shpërndarjes së fondit si ndihmë financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike në masën përkatësisht:

- 70 për qind sipas numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare;
- 20 për qind në mënyrë të barabartë ndërmjet partive parlamentare dhe partive politike që kanë përfituar mbi 10 000 vota në zgjedhjet e fundit parlamentare;
- 10 për qind sipas përqindjes së fituar ndërmjet partive politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe kanë fituar mbi 1 për qind të votave në shkallë vendi. Pjesa që mbetet pa u shpërndarë nga 10-përqindëshi i shtohet fondit prej 70 përqindësh dhe u ndahet partive parlamentare. Me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, qeveria ka përcaktuar fondin prej 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh si mbështetje financiare për partitë politike për vitin 2024. E njejta vlerë fondi në fakt që ka qenë dhe për vitin 2023. Në bazë dhe për zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektakti për shpërndarjen e këtyre fondeve. Shuma totale që përfiton secila parti politike si mbështetje financiare vjetore për vitin 2024, është shumatoria e të gjitha shumave që rezulton nga llogaritjet e përcaktuara në tre geramat që përmenda më lart, referuar pikës 4 të nenit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.02.2024*

19 të ligjit “Për partitë politike”. Duhet të theksojmë se kjo ndihmë financiare vjetore, në çdo rast do të jepet, vetëm nëse partia politike ka dorëzuar paraprakisht raportin financiar të vitit paraardhës, sipas rregullave të përcaktuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Nëse është e nevojshme të lexojmë dhe shumën që përfiton secila parti politike?

Z. I. Celibashi: Po mund ta bëjmë një lexim të fondeve që parashikon se do të përfitojë çdo parti politike si ndihmë financiare për vitin 2024.

Znj. J. Josifi: Partia Socialiste e Shqipërisë përfiton 151.494.783 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

- Partia Demokratike përfiton 106.661.181 (njëqind e gjashtë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë.

Z. I. Celibashi: Kjo është shuma totale?

Znj. J. Josifi: Po lexoj vetëm shumën totale të llogaritur në bazë të shpërndarjes së 70 përqindëshit të fondit, 20 përqind dhe 10 përqind.

- Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet përfiton 9.753.658 (nëntë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë.

- Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut përfiton 8.018.647 (tetë milion e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë) lekë.

- Partia Republikane Shqiptare përfiton 11.488.669 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.02.2024*

- Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë përfiton 8.018.647 (tetë milionë e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) lekë.
- Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar përfiton 8.018.647 (tetë milionë e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) lekë.
- Partia Lëvizja e Legalitetit përfiton 8.018.647 (tetë milionë e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë) lekë.
- Partia e Lirisë përfiton 15.577.215 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekë.
- Partia Socialdemokrate përfiton 12.266.269 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.
- Partia Nisma Thurje përfiton 6.283.636 (gjashtë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë. Pra, i gjithë fondi prej 345.600.000 (treqind e dyzet e pesë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit, ndahet sipas shumave të përmendura më lart. Për sa më sipër projektvendimi për miratimin tuaj.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po zoti Sefa, përfaqësues i Partisë Demokratike!

Z. I. Sefa, përfaqësues i Partisë Demokratike: Dakord me projektvendimin zoti Komisioner. Nuk kemi asnjë problematikë në lidhje me propozimin që ka bërë administrata e KQZ-së. Unë doja të shtoja vetëm diçka në lidhje me një VKM nr. 255, datë 24.03.2023 që ka bërë Këshilli i Ministrave dhe që lidhet me ligjin “Për Partitë Politike” dhe për ambientet e zyrave vendore. Nuk e di nëse KQZ-ja është e njohur me këtë fakt?! Ka ngritur një strukturë për implementimin e dispozitave të kësaj VKM-je? Nga një procedurë e mëparshme që ka qenë në lidhje me pronat shtetërore, ne kemi raste konkrete ku bashkitë dhe organet qendrore na kanë kthyer

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.02.2024*

përgjigje që në bashki të caktuara nuk ka ambjente publike për t'jua vënë në dispozicion partive politike, të cilat përcaktohen në kushtet ligjore. Normalisht po bëhet një vit nga hyrja në fuqi e kësaj VKM-je dhe ne kemi vështirësi..., nga ana juaj është ngritur ndonjë grup pune në lidhje me zbatueshmërinë e kësaj VKM-je, sepse ju lidh ju si institucion kryesor në administrimin e informacionit. Gjithsesi, kjo është për një moment të dytë që ne do të konkretizojmë dhe do të kërkojmë dhe mbështetjen tuaj. Kemi shumë bashki që ose i paguajmë financiarisht me buxhetin që na ka dhënë KQZ-ja sot, ose jemi në mungesë të një ambjenti për të ushtruar aktivitetin politik sipas përcaktimit të ligjit.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit zoti Sefa! Po natyrisht që ne jemi në dijeni të këtij vendimi të Këshillit të Ministrave. Deri më tani një kërkesë kemi pasur nga një parti politike, sipas së cilës është kërkuar mbështetje financiare për çështjen e ambjenteve dhe selive të partive politike. Ka një procedurë që e ka përcaktuar ai vendim i Këshillit të Ministrave. Në momentin që ju do ta vlerësoni, do të depozitoni një kërkesë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ne, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, do ta konsiderojmë këtë kërkesë. Por, ka një proces që i paraprin, i cili lidhet me vetë partinë politike që paraqet kërkesën, interesin Ministrisë së Brendshme dhe pastaj vjen te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili vlerëson faktin që ju keni qenë në pamundësi, ose të themi Ministria e Brendshme ka qenë në pamundësi për të siguruar selinë një partie politike të caktuar. Me pak fjalë, struktura përgjegjëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve deri më tani ka trajtuar vetëm një rast, sepse vetëm një kërkesë kemi pasur. Nëse do të kemi kërkesa të tjera, natyrisht jemi të detyruar që t'i trajtojmë. Në lidhje me këtë s'kemi?! Gjithsesi vendimin për këtë projektakt do ta marrim ditën e martë të javës tjetër. Jemi duke konsideruar dhe një kërkesë që ka ardhur nga Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet në lidhje me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.02.2024*

shpërndarjen e fondeve vjetore për vitin 2024. Do ta konsiderojmë dhe atë si kërkesë dhe do të vendosim ditën e martë.

Z. I. Sefa, përfaqësues i Partisë Demokratike: Dispozita është fare e qartë, i nderuar Komisioner! Thotë: rezultati i marrë në zgjedhjet e fundit parlamentare. Rezultati i marrë në zgjedhjet e fundit parlamentare janë vendimmarrjet e Komisionerit në lidhje me vendimin për caktimin e rezultatit. Të gjitha lëvizjet e brendshme brenda deputetëve, ose grupeve parlamentare, nuk mund të ndikojnë në rezultatin e partisë politike në momentin... dmth që është rezultati zgjedhor. Kemi rastin konkret, deputeti i LSI ka ikur nga LSI dhe ka shkuar tek PS. Kjo nuk do të thotë që PS të bëjë kërkesë që dhe rezultatin e marrë nga LSI, apo Partia e Lirisë, t'ia kalojë si fond zgjedhor. Nuk është me numër deputetësh, por është me rezultat zgjedhor. Për hir të koalicionit, rezultati zgjedhor përcaktohet sipas numrave që kanë dalë si deputetë, por jo çdo ndryshim i mëvonshëm duhet reflektuar në rezultatin zgjedhor. Rezultati zgjedhor është ai, ka dy deputetë në mos gaboj, siç kanë të tjerët nga një deputet, sepse ai është rezultati zgjedhor në bazë të preferencës së qytetarëve shqiptarë. Ndryshime të mëvonshme nuk mund të reflektohen. Ky është qëndrimi që donim të mbanim dhe që jemi edhe sot prezent për t'ia vënë në dispozicion Komisionerit, qëndrimin e Partisë Demokratike.

Z. I. Celibashi: Në rregull, faleminderit! Gjithsesi, po marrim kohën që duhet për ta vlerësuar gjithë këtë diskutim lidhur dhe me këtë element të vendimmarrjes. Do të keni njoftim për orën e seancës së ditës së martë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.02.2024*

16.02.2024
Ora 12:28

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, z. Hamit Ibrahim Berisha”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

- **Stafi KQZ: Znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.**

Parti Politike: PD (Z. Indrit Sefa)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë.

Znj. P. Doçaj: Faleminderit! Me shkresën nr. 518/2 Prot., datë 03.01.2024, Këshilli i Bashkisë Tropojë na ka njoftuar për krijimin e vakancës nga këshilltari, zoti Dritan Fadil Gjongecaj, propozuar nga subjekti politik Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Referuar nenit 164, të Kodit Zgjedhor, mandati i këshilltarit i kalon numrit rendor 5, që ka të bëjë me zotin Hamit Ibrahim Berisha. Nga ana jonë janë kryer verifikimet përkatëse. Kemi verifikuar “prima face” formularin e vetëdeklarimit të depozituar nga zoti Hamit Berisha, nga ku rezulton se nuk ka asnjë të dhënë që të bëjë të jetë në kushtet e ndalimit në referim të ligjin nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i është drejtuar zyrës së gjendjes gjyqësore dhe Drejtorisë së

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.02.2024*

Përgjithshme të Gjendjes Civile, duke kërkuar informacion në lidhje me ndryshimet e gjendjes civile dhe në lidhje me vendimet e formës së prerë penale që mund të ketë në ngarkim ky kandidat për këshilltar. Ka rezultuar që nuk ka vendime penale të formës së prerë dhe nuk ka asnjë ndryshim në gjeneralitete. Për këtë motiv në mbështetje të ligjit ky kandidat për këshillin e bashkisë nuk përbën kusht për moszgjedhjen si kandidat në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur dhe projektvendimi për miratimin tuaj.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tropojë, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zotin Hamit Ibrahim Berisha.

Vendimi nr. 19

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 16.02.2024*

16.02.2024
Ora 12:30

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kristian Luigj Shkreli, kryetar bashkie në Bashkinë Vau-Dejës, Qarku Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: PD (Z. Indrit Sefa)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Në lidhje me pikën tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Kristian Shkreli, kryetar bashkie në Bashkinë Vau-Dejës, do ta shtyjmë për ditën e martë për të marrë pak kohë më shumë për të vlerësuar dokumentacionin që lidhet me këtë çështje. Mirë, çështje të tjera nuk kemi sot në rendin e ditës. Faleminderit! Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*